

VENDIM
Nr.553, datë 11.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1619, DATË 2.7.2008
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE,
GRUPIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE PËR EFEKT PAGE DHE
CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË
QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe të neneve 24, 32 e 54 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronjat “a” deri në “e” të pikës 1 të vendimit, ndryshohen si më poshtë vijon:

“a. Për Bashkinë e Tiranës:

- Kryetari 138 750 - 173 400 lekë;

- Nënkryetari 130 000 - 138 750 lekë.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore me mbi 100 000 banorë:

- Kryetari 92 000 - 138 750 lekë;

- Nënkryetari 60 000 - 92 000 lekë.

c) Për njësitë e qeverisjes vendore me 50 001 - 100 000 banorë:

- Kryetari 60 000 - 115 000 lekë;

- Nënkryetari 49 000 - 90 000 lekë.

ç) Për njësitë e qeverisjes vendore me 20 001 - 50 000 banorë:

- Kryetari 51 000 - 90 000 lekë;

- Nënkryetari 41 000 - 77 000 lekë.

d) Për njësitë e qeverisjes vendore me 5 001 - 20 000 banorë:

- Kryetari 41 000 - 77 000 lekë;

- Nënkryetari 28 000 - 68 000 lekë.

dh) Për njësitë e qeverisjes vendore me nën 5 000 banorë:

- Kryetari 37 000 - 54 000 lekë;

- Nënkryetari 27 000 - 42 000 lekë.”.

b) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të Bashkisë së Tiranës”, që përmendet në pikën 2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.2 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe për nëpunësit e komunave”, që përmendet në pikën 3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Lidhja nr.3 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të këshillit të qarkut”, që përmendet në pikën 4, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Lidhja nr.7, që përmendet në pikën 5, zëvendësohet me lidhjen numër nr.6, “Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

dh) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Shtesa për kualifikim (kolona 4 e lidhjeve nr.1 dhe nr. 3) është 0.”.

e) Lidhja nr.5 “Struktura dhe kufijtë e pagave për punonjësit e policisë të bashkive e të komunave”, që përmendet në pikën 13, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ë) Në pikën 18, vlera “... 31000 lekë në muaj”, bëhet “...32000 lekë në muaj”.

f) Në pikën 19, vlera “... nga 19 000 deri në 31 000 lekë në muaj”, bëhet “... nga 20 000 deri në 32 000 lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2011, do të përballohen nga të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha